 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbylljen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publike dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimi i fushave për trajnimet e mësuesve:

Referuar Raportit të identifikimit të nevojave të punonjësve arsimorë për zhvillimin profesional, vlerësimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në DRAP Korçë, rezultoi së interesi më i lartë i mësuesve për tu trajnuar është fusha : Mësimdhënia dhe të Nxëniet e ndarë në module si më poshtë:

1.Integrimi i TIK në planifikimin mësimor dhe mësimdhënien. Shembuj praktikë të përdorimit të mjeteve digjitale. (Fusha e trajnimit:Mësimdhënia dhe të nxëniet. Lënda Teknologji, Informacion dhe Komunikim).

Moduli duhet të aftësojë mësuesit në përdorimin e mjeteve TIK në klasë dhe krijimin e përmbajtjeve digjitale.

Kriteret minimale:

- Të trajtojë integrimin e TIK në planifikimin mësimor.
- Të ofrojë shembuj praktikë të përdorimit të mjeteve digjitale.

2. *Njohuri mbi mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë online. (Fusha e trajnimit : Mësimdhënia dhe të nxënit. Lënda Teknologji , Informacion dhe Komunikim)*

Moduli duhet të aftësojë mësuesit në aplikimin e standardeve të sigurisë në internet

Kriteret minimale:

- Të përfshijë njohuri mbi mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë online.

3. *Trajnime për mësuesit ndihmës për zhvillimin e strategjive për përfshirjen e mbështetjen individuale të nxënësve me nevoja të veçanta. (Fusha e trajnimit : Mësimdhënia dhe të Nxënit. Mësimdhënia për nxënësit me nevoja të veçanta)*

Moduli duhet të mbështesë mësuesit ndihmës në zhvillimin e strategjive për përfshirjen dhe mbështetjen individuale të nxënësve me nevoja të veçanta.

Kriteret minimale:

- Të trajtojnë diferencimin e mësimdhënies sipas nevojave të nxënësve.
- Të ofrojnë teknika bashkëpunimi me mësuesit e klasës dhe prindërit.
- Të përfshijnë shembuj nga praktika gjithëpërfshirëse.

4. *Metoda interaktive dhe krijuese në mësimdhënie-nxënie nëpërmjet zhvillimit të praktikave mësimore për të rritur motivimin e nxënësve.) (Fusha e trajnimit: Mësimdhënia dhe të nxënit . Metodologji të mësimdhënies-nxënies)*

Moduli duhet të përqendrohet në zhvillimin e praktikave mësimore aktive, pjesëmarrëse dhe krijuese për të rritur motivimin e nxënësve.

Kriteret minimale:

- Të prezantojnë metoda interaktive (debate, punë në grup, lojëra mësimore).
- Të përmbajnë teknika të të nxënit të bazuar në projekte dhe problem-zgjidhje.
- Të ofrojnë mjete praktike për nxitjen e mendimit kritik dhe krijues.

5. *Trajnime për mësuesit koordinatorë të këshillimit të karrierës dhe mësuesit kujdestarë për këshillimin e nxënësve në zgjedhjet arsimore dhe profesionale, duke i mbështetur në zhvillimin e aftësive për jetën. (Fusha e trajnimit: Mësimdhënia dhe të nxënit. Zhvillimi i kompetencave kyç dhe aftësive për jetën)*

Moduli duhet të aftësojë mësuesit për këshillimin e nxënësve në zgjedhjet arsimore dhe profesionale, duke i mbështetur në zhvillimin e aftësive për jetën.

Kriteret minimale:

- Të ofrojnë mjete për identifikimin e interesave dhe prirjeve të nxënësve.
- Të përmbajnë praktika për orientimin drejt karrierës.
- Të përfshijnë aftësi vendimmarrëse dhe zgjedhje të informuara.

6. *Trajnime për mësuesit e lëndës Histori për forcimin e kompetencave profesionale të mësuesve të historisë në veprimtaritë ekstrakurrikulare. (Fusha e trajnimit: Mësimdhënia dhe të nxënit. Lënda Histori)*

Modulet duhet të forcojnë kompetencat profesionale të mësuesve të historisë, duke integruar metoda bashkëkohore dhe qasje ndërdisiplinore.

Kriteret minimale:

- Të përfshijnë strategji të mësimdhënies së bazuar në kompetenca.
- Të trajtojnë përdorimin e burimeve digjitale dhe hartave interaktive.
- Të ofrojnë praktika për lidhjen e temave historike me jetën lokale.

7. Trajnime për mësuesit e Edukimit Fizik për zbatimin e kurrikulës me kompetenca dhe gjithëpërfshirëse në lëndën e Edukimit Fizik dhe Shëndet. (Fusha e trajnimit: Mësimdhënia dhe të nxënit. Lënda Edukim Fizik dhe Shëndet).

Modulet duhet të kontribuojnë në zhvillimin profesional të mësuesve të edukimit fizik për rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe kompetencave të nxënësve.

Kriteret minimale:

- Të përfshijnë teknika për zhvillimin motorik dhe shëndetin fizik të nxënësve.
- Të ofrojnë modele për integrimin e lojës dhe sportit në procesin mësimor.
- Të trajtojnë sigurinë dhe edukimin shëndetësor në aktivitetet fizike.

Trajnimet duhet të ofrojnë pajisjen e mësuesve pjesmarrës me kredite. Sipas Udhëzimit Nr. 16, dt. 22.7.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, neni 6 pika 1 dhe 2 për nevojën e mësuesve për të pasur 8 kredite të detyruara sipas llogaritjes së shtojcës 2 në të cilën vlerësohet 1 orë trajnim i barabartë me 1 kredit:

SHTOJCA NR. 2
KREDITET SIPAS LLOJEVE TË ZHVILLIMIT TË VAZHDUESHËM
PROFESIONAL

Nr.	Emërtimi i aktivitetit	Kreditet (orët)
Aktivitetet të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në nivel ndërkombëtar		
1.	Pjesëmarrje në trajnime/seminare/workshope/mikrokredenciale ndërkombëtare	1 orë = 1,5 kredit
2.	Roli në cilësinë e trajnerit në trajnime/seminare/workshope/mikrokredenciale ndërkombëtare	1 orë = 3 kredite
3.	Pjesëmarrje në konferencë ndërkombëtare	1 orë = 1,5 kredit
4.	Referim në konferencë ndërkombëtare	1 orë = 3 kredite
5.	Botim në revistë ndërkombëtare	Autor i parë = 8 orë = 8 kredite; autor i dytë etj. = 4 orë = 4 kredite
6.	Përgatitja e nxënësve fitues në konkurse, olimpiada ndërkombëtare.	Vendi i parë: 8 orë = 8 kredite Vendi i dytë: 6 orë = 6 kredite Vendi i tretë: 5 orë = 5 kredite
Aktivitetet të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në nivel kombëtar		
7.	Pjesëmarrje në trajnime/seminare/workshope/mikrokredenciale	1 orë = 1 kredit

	kombëtare	
8.	Roli në cilësinë e trajnerit në trajnime/seminare/workshope/mikrokredenciale kombëtare	1 orë = 2 kredite
9.	Pjesëmarrje në konferencë kombëtare (maksimumi 4 orë)	1 orë = 1 kredit
10.	Referim në konferencë kombëtare (maksimumi 4 orë)	1 orë = 2 kredit
11.	Botim në revistë kombëtare, tekste jashtëshkollore në profilin përkatës.	Autor i parë = 6 orë = 6 kredite; autor i dytë etj. = 3 orë = 3 kredite
12.	Përgatitja e nxënësve fitues në konkurse, olimpiada kombëtare	Vendi i parë: 6 orë = 6 kredite Vendi i dytë: 4 orë = 4 kredite Vendi i tretë: 3 orë = 3 kredite
13.	Bashkëpunëtorë për hartimin e kurrikulës dhe materialeve mbështetëse për mësuesit, vlerësues të teksteve shkollore, provimeve kombëtare, moduleve/programeve të aktiviteteve të ZHVP-së	3 kredite
Aktivitetet të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në nivel njësie arsimore vendore		
14.	Pjesëmarrje dhe kontribute në takime të rrjetit profesional (maksimumi 8 takime të rrjetit profesional nga 1 orë secili)	2 orë = 0.5 kredite
15.	Drejtimi i rrjetit profesional (8 takime të rrjetit profesional nga 1 orë secili)	2 orë = 1 kredit
16.	Referim në rrjetin profesional (përveç drejtuesit të rrjetit nga 1 orë secili)	2 orë = 0.5 kredite

Në fund të trajnimit, agjencitë trajnuese duhet të pajisin mësuesit pjesmarrës me certifikatë trajnimi me 8 kredite.

Trajnimet parashikohen të zhvillohen për 3.000 mësues të shpërndarë në gjashtë qendra trajnimi, në gjashtë qytete të ndryshme. Përcaktimi i qendrave të trajnimit është bërë në nivel qarku, duke u bazuar në shpërndarjen gjeografike të ZVAP-ve nën varësinë e DRAP Korçë dhe në nevojën për të garantuar akses të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit. Nga 17 Zyrtarë Vendore të Arsimit Parauniversitar në varësi të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë, janë përzgjedhur 6 qendra trajnimi, në përputhje me tre kritere themelore: numrin e mësuesve të përcaktuar nga çdo ZVAP, afërsinë gjeografike të vendbanimeve të tyre dhe mundësitë infrastrukturore që ofrojnë

shkollat pritëse. Korça, Berati dhe Elbasani janë përcaktuar si qendra kryesore trajnimi për shkak të kapaciteteve të tyre të mëdha dhe kushteve optimale logjistike, ndërsa Përrenjasi, Pogradeci dhe Gramshi janë zgjedhur si qendra dytësore për të mundësuar përfshirjen e mësuesve që jetojnë në zona më të largëta nga qendrat e qarqeve.

Shpërndarja e grupeve sipas qendrave të trajnimit:

Nr.	MODULI	Nr. Punonjësve	Qendra e trajnimit ELBASAN	Qendra e trajnimit GRAMSH	Qendra e trajnimit KORÇË	Qendra e trajnimit PRRENJAS	Qendra e trajnimit POGRADECI	Qendra e trajnimeve BERAT
		3000	Nr. I grupeve	Nr. I grupeve	Nr. I grupeve	Nr. I grupeve	Nr. I grupeve	Nr. I grupeve
1	Integrimi i TIK në planifikimin mësimor dhe mësimdhënien. Shembuj praktikë të përdorimit të mjeteve digjitale.	400	8	0	3	0	1	4
2	Njohuri mbi mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë online.	425	5	0	5	1	2	4
3	Trajnime për mësuesit ndihmës për zhvillimin e strategjive për përfshirjen e mbështetjen individuale të nxënësve me nevojë të veçanta.	475	6	1	5	1	2	4
4	Metoda interaktive dhe krijuese në mësimdhënie-nxënie nëpërmjet zhvillimit të praktikave mësimore për të rritur motivimin e nxënësve.	500	8	1	4	1	1	5
5	Trajnime për mësuesit koordinatorë të këshillimit të karrierës dhe mësuesit kujdestarë për këshillimin e nxënësve në zgjedhjet arsimore dhe profesionale, duke i mbështetur në zhvillimin e aftësive për jetën.	450	7	1	3	1	2	4
6	Trajnime për mësuesit e lëndës Historisë për forcimin e kompetencave profesionale të mësuesve të historisë në veprimtaritë ekstrakurrikulare	575	8	1	6	1	2	5
7	Trajnime për mësuesit e edukimit fizik për zbatimin e kurrikulës me kompetenca dhe gjithëpërfshirëse në lëndën e Edukimit Fizik dhe Shëndet	175	3	0	2	0	1	1

Ndarja në grupe e mësuesve u përllogarit duke ju referuar Udhëzimit nr. 16 dt.22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” Shtojca 1.

Në kuadër të organizimit të trajnimeve rajonale në gjashtë qendrat e planifikuara (Berat, Korçë, Elbasan, Pogradec, Përrenjas dhe Gramsh), është bërë përcaktimi i trajnerëve dhe numrit të stafit ndihmës për çdo trajner, në varësi të përmasës së grupeve të trajnimit dhe numrit të pjesëmarrësve.

Kriteri kryesor në këtë përcaktim ka qenë efektiviteti i mbështetjes logjistike dhe pedagogjike që nevojitet për zhvillimin cilësor të procesit të trajnimit, në raport me numrin e grupeve dhe mësuesve të përfshirë në secilën qendër.

Numri i trajnerëve është përcaktuar nisur nga numri i moduleve të kërkuara për trajnim. Për shtatë module kërkohej shtatë trajnerë, një trajner për modul. Numri i stafit ndihmës është përcaktuar në varësi të numrit të pjesëmarrësve në secilën qendër trajnimi. Në këtë kuadër, në Berat, Korçë dhe Elbasan, ku numri i grupeve dhe pjesëmarrësve është më i lartë, janë caktuar nga dy staf ndihmës për çdo trajner, për të siguruar mbështetje të plotë gjatë fazave të ndarjes së grupeve, shpërndarjes së materialeve, raportimeve dhe koordinimit të pjesëmarrësve.

Në Pogradec, ku janë planifikuar 11 grupe, është vendosur një skemë 1.5 staf ndihmës për trajner, duke garantuar balancim të ngarkesës dhe fleksibilitet të mbështetjes.

Në Përrenjas dhe Gramsh, për shkak se janë parashikuar vetëm 4–5 grupe pjesëmarrësish, është caktuar nga një staf ndihmës për trajner, çka konsiderohet e mjaftueshme për menaxhimin e procesit trajnues në këto qendra.

Ky përcaktim është bërë me qëllim optimizimin e burimeve njerëzore dhe financiare, duke ruajtur një raport të drejtë midis mbështetjes teknike dhe nevojave reale të trajnimit në secilën qendër.

Trajnimet janë planifikuar të zhvillohen çdo fundjavë (të premte, të shtunë dhe të dielë) duke mos cënuar procesin mësimor. Trajnimi për secilin modul zgjat 8 orë nga të cilat gjashtë orë në sallë dhe 2 orë punë e pavarur në shtëpi. Gjatë trajnimit në sallë do të ketë një pushim 30 minuta në mes.

Nisur nga numri i grupeve për secilin modul në çdo qendër trajnimi komisioni ka kryer një parashikim për kohën e nevojshme për realizimin me sukses të kontatës :

Nr.	MODULI	Qendra e trajnimit ELBASAN	Qendra e trajnimit GRAMSH	Qendra e trajnimit KORÇË	Qendra e trajnimit PRRENJAS	Qendra e trajnimit POGRADEC	Qendra e trajnimeve BERAT
		Nr. i grupeve për secilin modul	Nr. i grupeve për secilin modul	Nr. i grupeve për secilin modul	Nr. i grupeve për secilin modul	Nr. i grupeve për secilin modul	Nr. i grupeve për secilin modul
1	Integrimi i TIK në planifikimin mësimor dhe mësimdhënien. Shembuj praktikë të përdorimit të mjeteve digjitale.	8	0	3	0	1	4
2	Njohuri mbi mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë online.	5	0	5	1	2	4
3	Trajnime për mësuesit ndihmës për zhvillimin e strategjive për përfshirjen e mbështetjen individuale të nxënësve me nevoja të veçanta.	6	1	5	1	2	4
4	Metoda interaktive dhe krijuese në mësimdhënie-nxënie nëpërmjet zhvillimit të praktikave mësimore për të rritur motivimin e nxënësve.	8	1	4	1	1	5
5	Trajnime për mësuesit koordinatorë të këshillimit të karrierës dhe mësuesit kujdestarë për këshillimin e nxënësve në zgjedhjet arsimore dhe profesionale, duke i mbështetur në zhvillimin e aftësive për jetën.	7	1	3	1	2	4
6	Trajnime për mësuesit e lëndës Historisë për forcimin e kompetencave profesionale të mësuesve të historisë në veprimtaritë ekstrakurrikulare	8	1	6	1	2	5

7	Trajnime për mësuesit e edukimit fizik për zbatimin e kurrikulës me kompetenca dhe gjithëpërfshirëse në lëndën e Edukimit Fizik dhe Shëndet	3	0	2	0	1	1
	Total grupe	45	4	28	5	11	27
	Ditë të parashikuara për realizimin e trajnimeve (gjithësej 19 ditë)	7	1	4	1	2	4

Kostot e trajnimit përfshijnë:

- Kostot për kredit dhe mësimdhënie
- Kostot organizative (çdo pjesmarrës duhet të pajiset me mjetet e nevojshme për trajnim: dosje, stilolaps, leksione të printuara dhe në fund certifikatën e trajnimit në format karton A4 me ngjyra)
- Kosto të pushimit (kafe, ujë, biskota)
- Kosto të transportit dhe akomodimit të trajnerëve , stafit mbështetës, transportit të bazës materiale në gjashtë qendrat e trajnimit të përcaktuara.

Për përcaktimin e koston për kredit Komisioni është bazuar në Udhezimin 16, dt. 22.7.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” si dhe referuar Urdhrit të ASCAP ”Për Miratimin e Udhëzuesit për procedurat dhe për kriteret e akreditimit dhe të njohjes së aktivitetit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për punonjësit arsimorë “*kreu V, pika 4:*

Nëse punonjësit arsimorë zgjedhin të zhvillojnë aktivitete të tjera të zhvillimit profesional përtej aktiviteteve të ofruara falas, tarifa për 8 kredite për aktivitete të tilla nuk duhet të kalojë tarifën minimale prej një krediti për ciklin e dytë të studimeve në fushën e mësuesisë, në institucionet publike të arsimit të lartë. Pra vlera e tarifës për 8 kredite nuk duhet të jetë më e lartë se 1300 lekë (ekuivalente afërsisht me tarifën për një kredit sipas sistemit të vjetër).

Referuar përcaktimit që çdo modul i kërkuar në këtë kontratë duhet të ofrojë 8 kredite, kostoja për çdo mësues pjesmarrës në modulet përkatëse llogaritet 1.083 lek pa TVSH/ mësues.

Tabela përmbledhëse sipas të cilës duhet të plotësohet shtojca Nr.2:

		Sasia	Njësia	Cmimi mesatar /njesi pa TVSH	Cmimi total pa TVSH në lek
Nr.	Çmimi për mësues përfshin:				Sasi*Cmim
I	Kosto trajnimi + materiale ndihmese per trajnim				
1	Kosto 8 kredite per mesues + kosto mesimdhënie trajneri	1	Mësues		

2	Kafe (ekspres, filter, kanaçe) + Ujë (0.5 litra bidon plastik) +Biskota (biskota çaji, kafe)	1	Mësues		
3	Dosje A4 e hollë me llastik	1	Mësues		
4	Stilolaps (blu Bic ose ekuivalent)	1	Mësues		
5	Leksionet e printuara me ngjyra Format A4 (20-25 fq)	1	Mësues		
6	Printim certifikata trajnimi , karton me ngjyra format A4	1	Mësues		
7	Totali I (shuma 1-6)				
II	Kosto transporti+akomodimi+diete ushqimore				
1	Qendra e trajnimit Elbasan (7 dite)				
	- 1.125 mësues të parashikuar për të marrë pjesë - 45 grupe të parashikuara për t'u krijuar (20-25 veta në grup) - koha e parashikuar për realizimin e trajnimeve- 7 ditë - numri i trajnereve të kërkuar – 7 trajnerë - numri i stafit mbështetës -14 staf	1	Qender trajnimi		
2	Qendra e trajnimit Gramsh (1 dite)				-
	- 100 mësues të parashikuar për të marrë pjesë - 4 grupe të parashikuara për t'u krijuar (20-25 veta në grup) - koha e parashikuar për realizimin e trajnimeve- 1 ditë - numri i trajnereve të kërkuar – 4 trajnerë - numri i stafit mbështetës -4 staf	1	Qender trajnimi		
3	Qendra e trajnimit Përrenjas (1 dite)				-
	o 125 mësues të parashikuar për të marrë pjesë o 5 grupe të parashikuara për t'u krijuar (20-25 veta në grup) o koha e parashikuar për realizimin e trajnimeve- 1 ditë o numri i trajnereve të kërkuar – 5 trajnerë o numri i stafit mbështetës -10 staf	1	Qender trajnimi		
4	Qendra e trajnimit Korçë (4 dite)				-
	o 700 mësues të parashikuar për të marrë pjesë	1	Qender trajnimi		

	- o 28 grupe të parashikuara për t'u krijuar (20-25 veta në grup) - o koha e parashikuar për realizimin e trajnimeve- 4 ditë - o numri i trajnereve të kërkuar – 7 trajnerë - o numri i stafit mbështetës -14 staf				
5	Qendra e trajnimit Pogradec (2 dite)				-
	- o 275 mësues të parashikuar për të marrë pjesë - o 11 grupe të parashikuara për t'u krijuar (20-25 veta në grup) - o koha e parashikuar për realizimin e trajnimeve- 2 ditë - o numri i trajnereve të kërkuar – 7 trajnerë - o numri i stafit mbështetës -10 staf	1	Qender trajnimi		
6	Qendra e trajnimit Berat (4 dite)				-
	- o 675 mësues të parashikuar për të marrë pjesë - o 27 grupe të parashikuara për t'u krijuar (20-25 veta në grup) - o koha e parashikuar për realizimin e trajnimeve- 4 ditë - o numri i trajnereve të kërkuar – 7 trajnerë - o numri i stafit mbështetës -14 staf	1	Qender trajnimi		
7	Totali Kosto organizative transporti+akomodimi+diete ushqimore (Shuma (1-6)				
8	Numri i mesuesve per trajnim				3,000
9	Totali II Kosto organizative per mesues (9= 7/8)				
10	Fondi për njësi pa TVSH (TOTALI I+TOTALI II)	1	mësues		
11	Numri i mesuesve per trajnim				3,000
12	TOTALI III pa TVSH (12 = 10*11)				

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “Trajnim i punonjësve mësimorë të Zyrave Vendore Arsimore në varësi të DRAP Korçë viti 2025”.

Afatet e ekzekutimit: Nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundimin e trajnimeve për të gjitha grupet e trajnimit.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Sipas grafikut të mëposhtëm :

Nr.	Qendrat e trajnimit	Nr. i moduleve	Nr. I grupeve	Dite trajnimi te parashikuara	Koha e trajnimit	Vendi	Koha
1	Qendra e trajnimit ELBASAN	6	45	7	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla ”Luigj Gurakuqi” Elbasan	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimeve
2	Qendra e trajnimit GRAMSH	4	4	1	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla ”Shefqet Guzi” Gramsh	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimeve
3	Qendra e trajnimit KORÇË	7	28	4	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla "Th.Germenji" Korçë	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimeve

4	Qendra e trajnimit PRRENJAS	5	5	1	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla ” Qybra Sokoli” Prrenjas	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimeve
5	Qendra e trajnimit POGRAD EC	7	11	2	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla ” Kolë Koci” Pogradec	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimeve
6	Qendra e trajnimeve BERAT	7	27	4	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla : ” 1 Maji” Berat	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimeve
	Total		120 grup e	19 dite trajnim			

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Trajnimi i mësuesve të profileve të ndryshme mësimore me qëllim rritjen e aftësive profesionale të tyre për modulet e planifikuara në këtë procedurë prokurimi në fushën Mësimdhënia dhe të Nxënësve dhe specifikimeve të moduleve si më poshte:

1. *Integrimi i TIK në planifikimin mësimor dhe mësimdhënien. Shembuj praktikë të përdorimit të mjeteve digjitale. (8 kredite)*
2. *Njohuri mbi mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë online. (8 kredite)*
3. *Trajnime për mësuesit ndihmës për zhvillimin e strategjive për përfshirjen e mbështetjen individuale të nxënësve me nevoja të veçanta. (8 kredite)*
4. *Metoda interaktive dhe krijuese në mësimdhënie-nxënie nëpërmjet zhvillimit të praktikave mësimore për të rritur motivimin e nxënësve.(8 kredite)*
5. *Trajnime për mësuesit koordinatorë të këshillimit të karrierës dhe mësuesit kujdestarë për këshillimin e nxënësve në zgjedhjet arsimore dhe profesionale, duke i mbështetur në zhvillimin e aftësive për jetën. (8 kredite)*
6. *Trajnime për mësuesit e lëndës Histori për forcimin e kompetencave profesionale të mësuesve të historisë në veprimtaritë ekstrakurrikulare.(8 kredite)*
7. *Trajnime për mësuesit e edukimit fizik për zbatimin e kurrikulës me kompetenca dhe gjithëpërfshirëse në lëndën e Edukimit Fizik dhe Shëndet..(8 kredite)*

Sipas Udhëzimit Nr. 16, dt. 22.7.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, neni 6 pika 1 dhe 2 për nevojën e mësuesve për të pasur 8 kredite të detyruara sipas llogaritjes së shtojcës 2 në të cilën vlerësohet 1 orë trajnim i barabartë me 1 kredit. Në fund të trajnimit, agjencitë trajnuese duhet të pajisin mësuesit pjesmarrës me certifikatë trajnimi me 8 kredite për secilin modul ku ata do të jenë pjesmarrës.

Detyrat:

Agjencitë trajnuese duhet të zbatojnë me korrektesë kërkesat e AK për realizimin me sukses të kontratës (kohën e trajnimit, shpërndarjen e trajnimeve, paraqitjen në qendrat e trajnimit në orar dhe me pajisjet e duhura (laptop, projektor, priza zgjatuese etj). DRAP Korce siguron ambjentet për zhvillimin e trajnimit por sigurimi i bazës material për të zhvilluar trajnimin do të kryhet nga operatori/ët ekonomikë fitues. Agjencitë trajnuese duhet të kenë të akredituara nga Ministria e Arsimit modulet për të cilat kërkohet trajnimi.

Agjencitë trajnuese duhet të identifikojnë në mënyrë korrekte listat emërore, sipas një formati standard që do u jepet nga DRAP Korçë, të mësuesve pjesmarrës në trajnim dhe të kenë në dispozicion të AK listat emërore përfundimtare të nënshkruara nga pjesmarrësit.

Shpërndarja:

Trajnimet do të zhvillohen për 3000 mësues gjithësej të organizuara me grupe me qendër në 6 (gjashtë) prej ZVA-ve në varësi të DRAP Korçë. Ndarja në grupe e mësuesve (gjithësej 120 grupe) u përlogarit duke ju referuar Udhëzimit nr. 16 dt.22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” Shtojca 1, secili grup përbëhet nga 20-25 persona.

Përcaktimi i qendrave të trajnimit është bërë në nivel qarku, duke u bazuar në shpërndarjen gjeografike të ZVAP-ve nën varësinë e DRAP Korçë dhe në nevojën për të garantuar akses të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit. Nga 17 ZVAP-të ekzistuese, janë përzgjedhur 6 qendra trajnimi, në përputhje me tre kritere themelore: numrin e mësuesve të përcaktuar nga çdo ZVAP, afërsinë gjeografike të vendbanimeve të tyre dhe mundësitë infrastrukturore që ofrojnë shkollat pritëse. Korça, Berati dhe Elbasani janë përcaktuar si qendra kryesore trajnimi për shkak të kapaciteteve të tyre të mëdha dhe kushteve optimale logjistike, ndërsa Përrenjas, Pogradeci dhe Gramshi janë zgjedhur si qendra dytësore për të mundësuar përfshirjen e mësuesve që jetojnë në zona më të largëta nga qendrat e qarqeve.

Nr.	MODULI	Nr. Punonjësve	Qendra e trajnimit ELBASAN	Qendra e trajnimit GRAMSH	Qendra e trajnimit KORÇË	Qendra e trajnimit PËRRENJAS	Qendra e trajnimit POGRADEC	Qendra e trajnimeve BERAT
		3000	Nr. I grupeve	Nr. I grupeve	Nr. I grupeve	Nr. I grupeve	Nr. I grupeve	Nr. I grupeve
1	Integrimi i TIK në planifikimin mësimor dhe mësimdhënien. Shembuj praktikë të përdorimit të mjeteve digjitale.	400	8	0	3	0	1	4
2	Njohuri mbi mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë online.	425	5	0	5	1	2	4
3	Trajnime për mësuesit ndihmës për zhvillimin e strategjive për përfshirjen e mbështetjen individuale të nxënësve me nevoja të veçanta.	475	6	1	5	1	2	4
4	Metoda interaktive dhe krijuese në mësimdhënie-nxënie nëpërmjet zhvillimit të praktikave mësimore për të rritur motivimin e nxënësve.	500	8	1	4	1	1	5
5	Trajnime për mësuesit koordinatorë të këshillimit të karrierës dhe mësuesit kujdestarë për këshillimin e nxënësve në zgjedhjet arsimore dhe profesionale, duke i mbështetur në zhvillimin e aftësive për jetën.	450	7	1	3	1	2	4
6	Trajnime për mësuesit e lëndës Historisë për forcimin e kompetencave profesionale të mësuesve të historisë në veprimtaritë ekstrakurrikulare	575	8	1	6	1	2	5
7	Trajnime për mësuesit e edukimit fizik për zbatimin e kurikulës me kompetenca dhe gjithëpërfshirëse në lëndën e Edukimit Fizik dhe Shëndet	175	3	0	2	0	1	1

Trajnimet janë planifikuar të zhvillohen çdo fundjavë (të premte, të shtunë dhe të dielë) duke mos cënuar procesin mësimor. Trajnimi për secilin modul zgjat 8 orë nga të cilat gjashtë orë në sallë dhe dy orë punë e pavarur në shtëpi. Gjatë trajnimit në sallë, do të ketë një pushim 30 minuta në mes.

Trajnimet do të zhvillohen në ambjentet e shkollave të mëposhtme :

- Qendra e trajnimit Elbasan : Shkolla ”Luigj Gurakuqi”
- Qendra e trajnimeve Gramsh : Shkolla ” Shefqet Guzi”
- Qendra e trajnimeve Korçë: Shkolla ” Themistokli Gërmenji”
- Qendra e trajnimeve Përrenjas : Shkolla ” Qybra Sokoli”
- Qendra e trajnimeve Pogradec : Shkolla ” Kolë Koci”
- Qendra e trajnimeve Berat : Shkolla : ” 1 Maji”

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:
Sipas grafikut të mëposhtëm:

Nr.	Qendrat e trajnimit	Nr. i module ve	Nr. I grupe ve	Dite trajnimi te parashiku ara	Koha e trajnimit	Vendi	Koha
1	Qendra e trajnimit ELBASAN	6	45	7	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla ”Luigj Gurakuqi” Elbasan	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimev e
2	Qendra e trajnimit GRAMSH	4	4	1	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla ” Shefqet Guzi” Gramsh	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimev e
3	Qendra e trajnimit KORÇË	7	28	4	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla "Th.Germenji" Korçë	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimev e
4	Qendra e trajnimit PRRENJAS	5	5	1	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla ” Qybra Sokoli” Prrenjas	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimev e
5	Qendra e trajnimit POGRAD EC	7	11	2	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30	Shkolla ” Kolë Koci” Pogradec	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimev e

					minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi		
6	Qendra e trajnimeve BERAT	7	27	4	Trajnimet do te zhvillohen ne fundjave : te premte, te shtune, te diele pa cenuar procesin mesimor duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e plote te trajnimeve Trajnimi per secilin modul zgjat 8 ore per cdo grup,nga te cilat gjashte ore trajnim ne salle me nje pushim 30 minuta ne mes dhe dy ore pune e pavarur ne shtepi	Shkolla : ” 1 Maji” Berat	Nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te trajnimeve
	Total		120 grupe	19 dite trajnim			

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

